

POLITIKA E PRIVATËSISË

Ky dokument paraqet një dokument zyrtar i cili përshkruan mënyrën se si “FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME I PRISHTINËS, mbledh, përpunon, ruan, ndan dhe mbron të dhënat personale të studentëve, stafit akademik dhe administrativ, vizitorëve dhe palëve të treta.

1. Kush i përpunon dhe është përgjegjës për të dhënat tuaja personale?

Fakulteti i Studimeve Islame i Prishtinës, është përpunuesi i të dhënave personale i cili përpunon të dhënat tuaja personale me përgjegjësi të plotë dhe në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe rregulloret përkatëse.

Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale: Email: vedat.shabani@fsi-edu.net Tel: +383 38 243 887

2. Cilat kategori të të dhënave përpunohen?

Fakulteti, varësisht nga rastet specifike dhe qëllimet, mund të përpunojë të dhëna të tilla si:

- Të dhëna identifikuese (emër, mbiemër, nr. personal, ID studentore);
- Të dhëna kontakti (email, adresë, telefon);
- Të dhëna akademike (diploma, nota, certifikata, aplikime, dëshmi të pjesëmarrjes);
- Të dhëna për punësim dhe marrëdhënie kontraktuale;
- Të dhëna financiare : informata për pagesa, bursa, apo ndihma studentore;
- Të dhëna të ndjeshme (të dhëna shëndetësore për rregullime arsimore apo mbështetje);
- Pamje foto/video të marra gjatë ngjarjeve universitare.

3. Për çfarë qëllimesh i përdorim të dhënat tuaja personale?

Të dhënat përpunohen për:

- Realizimin e funksioneve arsimore dhe administrative të fakultetit;
- Rekrutimin e stafit dhe pranimin e studentëve;
- Zbatimin e kontratave dhe marrëdhënieve ligjore;
- Organizimin e trajnimeve dhe ngjarjeve shkencore e publike;
- Sigurimin e infrastrukturës dhe sigurisë (përfshirë video-mbikëqytjen);
- Trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike;
- Promovimin e aktiviteteve akademike dhe kulturore.

4. Cila është baza ligjore për përpunimin?

Përpunimi i të dhënave personale bazohet në:

- Detyrime ligjore (përputhshmëri me Ligjin Nr. 06/L-082 dhe ligje të tjera përkatëse);
- Interesin legjitim të Fakultetit;
- Marrëdhënie kontraktuale;
- Pëlqimin e subjektit të të dhënave, kur është e nevojshme.

5. Me kë i ndajmë të dhënat personale të mbledhura?

Të dhënat tuaja personale mund të ndahen me:

- Autoritetet kompetente shtetërore (p.sh. MASHTI, AKA, AIP, etj.);
- Partnerë ndërkombëtarë akademikë (në kuadër të mobiliteteve dhe bashkëpunimeve);
- Palë të treta të kontraktuara (p.sh. për mirëmbajtje IT, hulumtime);
- Në rastet e kërkuara me ligj, organet e rendit apo gjyqësorin gjithnjë duke respektuar konfidencialitetin dhe sigurinë, si dhe gjithmonë në bashkëpunim dhe me pajtimin e dhënësit të të dhënave personale, përveç rasteve kur ndarja kërkohet nga ligji në mënyrë të detyrueshme.

6. Cilat janë të drejtat tuaja?

Subjektet e të dhënave kanë të drejtë:

- Të kenë qasje në të dhënat e tyre personale;
- Të kërkojnë korrigjim apo përditësim të të dhënave të pasakta;
- Të kërkojnë fshirjen (“e drejta për t’u harruar”) në raste të caktuara;
- Të kufizojnë përpunimin apo ta kundërshtojnë atë;
- Të parashtrijnë ankesë pranë AIP në rast të shkeljeve.

7. E drejta e ankimit

Në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082, çdo person që beson se i është shkelur e drejta për privatësi, mund të parashtrijë ankesë në formë fizike në Zyrën e Pranimi - Arhivën e Fakultetit “Fakulteti i Studimeve Islame, Rr. “Bajram Kelmendi” nr. 174, Prishtinë, apo në email adresën: info@fsi-edu.net

Në rastet kur nuk trajtohen ankesat apo konsideroni që po vazhdohet me shkelje të privatësisë atëherë ankesat parashtrihen tek:

Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) Rr. Zejnel Salihu nr. 22, 10000 Prishtinë Web: www.aip-rks.org

8. Siguria e të dhënave personale

Fakulteti zbaton masa të duhura teknike, fizike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale kundër qasjes, ndryshimit, humbjes apo shkatërrimit të paautorizuar. Të dhënat ruhen për periudhën që është e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të përpunimit dhe sipas Ligjit për Arkiva dhe rregullave të brendshme për menaxhimin e dokumenteve.

9. Përditësimi i Politikës së Privatësisë

Kjo politikë mund të përditësohet kohë pas kohe. Versioni më i fundit publikohet në faqen zyrtare të Fakultetit (www.fsi-edu.net). Faqja mund të përmbajë lidhje me faqe të tjera, për të cilat Fakulteti nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen apo politikat e privatësisë së tyre, dhe të cilat ju rekomandon të i lexoni .